

VEÇANTI NË NDARJET KANUNORE NË DIBËR TË POSHTME

Haki PËRNEZHA

Studiues, Akademia "Rrënjët Tona"

PËRMBLEDHJE

Krahina e Dibrës, prezantohet me dy ndarje të quajtura Malësia (Malet e Dibrës) dhe Topalltia, ose pjesa fushore e Dibrës. Emërtime të tilla Malësi e Topallti, apo që përkojnë me fjalën "fushë", hasim edhe në zona tjera si në Tiranë, Krujë, Elbasan, etj., por në Dibër emërtimet e mësipërme marrin vlera të mëdha historike dhe etnokulturore. Malësia është parë gjithmonë si areali, ku ndërthuret ideologjia fisnore me atë fshatare dhe për pasojë edhe si qendra e ruajtjes dhe zhvillimit dinamik të elementeve të së drejtës zakonore. Malësia e Dibrës e cila përbëhet figurativisht nga nëntë Male ose nëntë Krahina, përmbledh nëntë njësi etnokulturore, të cilat janë qeverisur më vete, por duke pasë të njëjtin organizim. Një numër i madh fisesh të grupuara në fshatra pranë e pranë njëri tjetrit, kanë formuar njësi më të mëdha që u quajtën fillimisht Male, më vonë Krahina dhe pas vitit 1800 u quajtën edhe konaçe. Të tilla janë Reçi, Dardha, Çidhna, Muhurri, Luzni, 4 Grykët, Gryka e Madhe, Gryka e Vogël, Bulqiza. Megjithë ndryshimet në mes Maleve përsëri ato kishin karakteristika të përbashkëta: Në themel të organizimit administrativ ishin konaçet dhe çdo konak paraqitej si një minishtet. Ai kishte 'Aga-in' (ndryshe egzekutivi), Plakun (ose gjyqsori), Dheu-n (parlamenti), si dhe Flamurtarin ose (bajrakmbajtësin). Karakteristikë e përbashkët e Maleve është se ato vetqeveriseshin sipas së drejtës zakonore dhe zbatonin Kanunin e Skënderbeut. Qënia përballë gjeografikisht me një pjesë të territorit, ku perandoria osmane kishte ndërhyrë në të drejtën zakonore, Malet u detyruan ta ruajnë me fanatizëm atë, ndaj dhe praktikat kanunore, krijimet mbi shtratin etnojuridik të trevës, janë brilante dhe të pafundme. Ndër to dallojnë *Kanuni në kalë*, *Kanuni me shekë të kosi*, *Kanuni me këmesë*, etj, etj. Histori kanunore e legjenda të ndryshme e bëjnë trashëgiminë gojore dibrane një minierë të artë të kulturës popullore.

Fjalë kyçe: plak, stërplak, çekiç, shekë (kosi), konak, esnaf bagëtiye, kthim i gruas "mbarë", grua "halli", jetojmë me të "mshela", e dalmja fare, buka e pajtimit.

ABSTRACT

The province of Dibra is presented with two divisions called Malesia (Mountains of Dibra) and Topalltia, or the plain part of Dibra. Such names Malesi and Topallti, or corresponding to the word "field", are also found in other areas such as Tirana, Kruja, Elbasani, etc. but in Dibra the above names take on great historical and ethnocultural values. Malesia has always been seen as an area where tribal and rural ideology intertwine and consequently as a center for the preservation and dynamic development of elements of customary law. The Dibra Highlands, which figuratively consists of Nine Mountains or Nine Provinces, comprises nine ethnocultural units which are governed separately, but having the same organization. A large number of tribes grouped in villages next to each other, have formed larger units that were initially called Mountains later Krahina and after 1800 were also called lodges (konak). Such are Reçi, Dardha, Çidhna, Muhurri, Luznia, Katwr Grykws, Gryka e Vogwl, Gryka e Madhe, Bulqiza. Despite the differences between the Mountains again they had common features: At the core of the administrative organization were the lodgings and each inn was presented as a mini-state, it had 'Aga-in' (otherwise the executive), the Elder (or judiciary), Dheu (parliament), and the flagbearer or (flagbearer). A common feature of the Mountains is that they governed themselves according to the Canon Law by applying the Canon of Scanderbeg. Faced geographically with a part of the territory where the Ottoman Empire had intervened in Canon law, the Mountains were forced to fanatically preserve it, and therefore the canonical practices, the creations on the ethno-legal bed of the region, are brilliant and endless. Among them are the Kanun on horseback, the Kanun

with sour cream, the Kanun with ax, etc. Various canonical histories and legends make the Diber oral heritage a golden mine of popular culture.

Key words: old man, old man, hammer, sheke (yogurt), inn, cattle guild, return of the "good" woman, "poor" woman, we live with her "mshela", the exit at all, the bread of reconciliation.

HYRJE

Traditat ndër shqiptarë kanë ngjashmëri njëra me tjetrën, por edhe dallime e veçori nga një krahinë në tjetrën. Krahinat (Malet) e Dibrës përkundër disa ndryshimeve të vogla, në lëmin e organizimit të Vetqeverisjes sipas së drejtës dokësore, kanë ngjashmëri të plotë e cila, tregon dhe shkakun pse emërtimi "Nëntë Malet e Dibrës" erdhi deri në ditët tona. Ruajtja e së drejtës për tu vetqeverisur sipas dokeve vendore veç tjerash pati rëndësi se i siguroi "mbijetesë rendit fisnor, si një formë vetmbrojtjeje prej ligjeve të një perandorie teokratike dhe ushtarake"⁽¹⁾ Kjo e drejtë, është "përkundur" në shtratin e rendit etnojuridik, i cili sipas etnologëve "është shumë më i hershëm se ai i kanuneve"⁽²⁾ dhe që ka lulëzuar para pushtimit osman. Këtë pasuri e vlerë shpirtërore, në shekuj nuk e humbën as ilirët nën sundimin romak e as arbërit nën sundimin bizantin. Në bashkësitë e tyre ata gëzonin një farë vetëqeverisjeje dhe zbatonin të drejtën zakonore lokale, sidomos në çeshtjet gjyqësore."⁽³⁾ Studiuesë të ndryshëm, realizimin e vetqeverisjes e lidhin edhe me shkallën e madhe të urbanizimit të trevës që në periudhën e kalimit prej lashtësisë antike në atë mesjetare.⁽⁴⁾

VEÇANTI NË NDARJET KANUNORE NË DIBËR TË POSHTME

Është e kuptueshme që ky zhvillim e urbanizim mesjetar, nënkupton edhe zhvillimin e rendit etnojuridik, i cili në fund të fundit shprehej me rregulla e parime të cilat rregullonin jetën e malësorëve. Këto rregulla, të quajtura "kanun", i cili "mësohej përmendësh si një trashëgimi." dhe që mbijetoi falë përpjekjeve e luftrave të shumëta "me armë në dorë kundra sllovenve e kundra turqve"⁽⁶⁾ u ruajtën dhe u mbajtën gjallë deri në ditët tona. Çdo mal a krahinë në Dibër, por edhe më gjërë, kishte kontributin e vet në këtë mori rregullash e parimesh, fillimisht morale e më vonë edhe norma juridike të cilat mbartnin "të gjitha tiparet e një të drejte që shkon në përputhje relative me besimet dhe me vlerat morale."⁽⁷⁾ të asaj shoqërie që gjallonte në trevën dibrane. Kështu prej kohësh, në etninë dibrane të vendosur si në pjesën malore, por edhe në atë fushore të Dibrës, përdorej tradita vendase në zgjidhjen e problemeve të së drejtës dhe kjo si "dëshmi e lashtësisë dhe mbijetesë kulturore."⁽⁸⁾

Pas vitit 1839, trysnia e pushtetit osman ia arriti të ndërhyjë dhe të imponojë zbatimin e shariatit në pjesën fushore të Dibrës e për pasojë u shkatërruan elementët e vetqeverisjes. Ndërsa në pjesën malore, tentativa osmane për të ndërhyrë në sistemin juridik ngjalli revoltë të madhe e cila solli edhe Luftën kundër Hajredin Pashës 1844. Malet e Dibrës ia arritën ta ruajnë të paprekur vetqeverisjen sipas së drejtës zakonore, e cila sipas Pulahës, vetëm në këtë mënyrë, njësitë krahinore mundën t'i siguronin individit "mbrojtjen e gjithë kolektivit, të fshatit e gjithë krahinës."⁽⁹⁾ Pavarësisht nga lloji i pushtuesit të radhës që ka shkelë këto troje, ligjet zakonore, të cilat kanë rregulluar jetën shoqërore në male, i janë nënshtruar një procesi të gjatë dinamik, duke iu përshtatur rrethanave të krijuara. Zhan Klod Faveirial vëren se malësorët janë të përjashtuar nga taksa e së dhjetës dhe taksa e tokës. Ata udhëhiqen nga disa ligje zakonore që kryetarët e fiseve i zbatojnë në çështje civile dhe kriminale, pa asnjë ndërhyrje të gjyqësorve turq.⁽¹⁰⁾ Edhe akademik Kristo Frashëri, vëren të njëjtën gjë kur thekson dy nga tre figurat që mbajtën më këmbë Vetqeverisjen në Malet e Dibrës. Ai përmend dy figurat e larta të shoqërisë patriarkore Plaku, këqyrin e së drejtës zakonore dhe Kefalinë, udhëheqësin ushtarak të bashkësisë.¹¹ Duke vlerësuar se e drejta është ideali i ligjit dhe jo e kundërta¹² në të gjithë njësitë etnokulturore dibrane në përgjithësi dhe në ato të Dibrës së poshtëme në veçanti, janë evidentuar përpjekje serioze në dhënien e drejtësisë. Dhe kjo ka ardhë pasi në Dibër të Poshtëme ka qënë i madh

kapaciteti i fiseve për të nxjerrë pleqë kanuntarë. Prof. Nebi Bardhoshi këtë e quan hierarki, e cila vlerësohet më së tepërmi për të klasifikuar fiset, fshatrat, krahinat¹³.

Pleqë të ndryshëm dibranë të regjur në punë të kanunit, kanë shkëlqyer në dhënien e zgjidhjeve interesante në situata të ndërlikuara. Shpeshherë ata kanë krijuar mbi shtratin a mbi kornizën e së drejtës zakonore, duke "prodhuar" norma të reja juridike. Sipas Pospisil-it "*secila bashkësi apo nivel social ka kapacitetin të krijojë normat e veta juridike*".¹⁴ Jo rrallë herë këto norma janë shndërruar në zgjidhje, duke u bërë *kazus* dhe kanë shërbyer si *motërzime* për raste të tjera të ngjashme, si brenda ashtu edhe jashta krahinës. Të tilla kanë qënë praktikat kanunore të zhvilluara në zona të përmenduar si Çidhna, Luznia, Muhurri, etj, etj. Pleqë kanuntarë të dalë nga fise të shquara si Murrja, Pira, Noka, Lusha, etj., kanë kontribute të prekshme në lëmin e së drejtës zakonore. Pleqtë e Çidhnës, dhe jo vetëm, shpesh herë thirrëshin edhe nga krahinat tjera për të ndarë kanune dhe kjo ndodhte pasi "*kufiri krahinor nuk konsiderohej si kufi ligjor*".¹⁵ "*Heret - heret, - shkruan Shtjefën Gjeçovi, ndër të gjitha krahinat e malet e Mirditës, të Thkellës, të Malësisë së Lezhës, etj. Lusha e Noka në Qidhën të Dibrës janë pvetë ndër gjyqe e pleqni me kanu*".⁽¹⁶⁾ Ende në kujtesën popullore dibrane ruhen disa raste, që zor se shekujt që vijnë, do t'i pluhurosën. Kështu, në të folurën e përditshme ende dëgjon të përmenden togfjalëshat si: 1. *Kanuni në kal'hipt'*; 2. *Kanuni i shekës së kosit*; 3. *Kanuni i ndarë me këmesë apo edhe 4. Pajtim, o dilni fare!* Ne zgjodhëm katër forma të cilat kanë qasje të veçantë në rrafshin e së drejtës zakonore apo kanunin në Dibër.

1. Rasti i parë flet për një praktikë kanunore e quajtur "*Kanuni në kalë*", por që është shumë e vështirë për tu zhvilluar, ndaj dhe rastet mbeten të rrallë.
2. Rasti i dytë, ose *Kanuni i shekës së kosit* tregon se si njohuritë praktike a teknike shërbejnë për të dhënë zgjidhje përplasjeve në mes njerzëve.
3. Rasti i tretë, na njeh me një mënyrë rënqethëse për ndarjen e së drejtës. Mjeti dhe mënyra e përdorur nga plaku i kanunit për të "ndarë" përgjysmë fëmijën e pretenduar nga dy gra, është kanibalesk, por që shërben për të zbardhur të vërtetën dhe dhënien e drejtësisë.
4. Rasti i katërt, na njeh me një formë të veçantë shtërngimi për pajtim. Kjo formë shtërngimi përdoret në ato raste, kur dështonin të gjithë mënyrat e pajtimit në mes palëve në konflikt.

Kanun në kalë

Çdonjeri prej nesh që ka ndenjtur në odën dibrane, besoj, i ka qëlluar të dëgjojë dhe për "kanuni në kalë", apo: "e ndan në kalë". Këto shprehje, ende sot, në të folurën e zonës përdoren për të treguar një person i cili është i zoti për t'i dhënë zgjidhje çdo problemi të koklavitur që lind në komunitet. Jo rrallë herë këto shprehje janë përdorë nga persona, të cilët në biseda të ndryshme vetdeklaroheshin, herë me shaka e herë seroizisht, duke u shprehur këtë problem unë e "*ndaj në kalë*". Po ç'është në të vërtetë *Kanuni në kalë*? Të gjithë lexuesit e dinë se kanunet bëheshin (apo ndaheshin) në odat e fshatarëve, në livadhe a kudo tjetër por jo në kalë. Ndërsa në Çidhën të Dibrës së Poshtëme, ka ndodhë që kanuni të ndahet edhe në kalë dhe ky ka qënë momenti më pikant ku zgjuarsia dhe mendjemprehtësia e pleqve çidhnakë, është shpalosur në të gjithë dimensionin e saj të mundshëm. Pleqtë çidhnakë, Lusha dhe Noka, duke ndarë kanunin në kalë, vendosën një standart që për shumë të tjerë mbetet i paarritshëm. Askund tjetër, përveçse në Çidhën, nuk është tentuar të përdoret kjo "praktikë" kanunore, *me nda kanunin në kalë*. Në fakt as në Kanunin e Lekës dhe as në atë të Arbërit (Skënderbeut) nuk është e përshkruar një "praktikë" e tillë dhe kjo, mendoj, për shkak të vështirësisë dhe kushteve të "rënda" për realizimin e kësaj "norme" kanunore. Ajo që e bën gati të pamundur ndarjen e kanunit *në kalë*, është *koha e paktë* që pleqtë e kanunit kanë në dispozicion për të ndarë të drejtën.

Për ndonjë që nuk ka informacionin e mjaftueshëm për sa flitet, po përpiqemi të sqarojmë "**procedurën**" e ndarjes së **kanunit në kalë** për të nxjerrë në pah se cila është vështirësia reale që kjo praktikë kanunore të mbetet "pronë" e pak pleqve. Le të përshkruajmë "hapat" që duhen bërë për të realizuar praktikën e ndarjes së një kanuni në kalë. Palët në konflikt zgjedhin pleqtë dhe janë ata pastaj që vendosin të ndajnë kanunin në kalë. Për këtë, ata në fillim caktojnë vendin e pikëpjekjes, i cili duhet të jetë një shesh, livadh apo lëndinë ku të ketë mjaftueshëm hapësirë për tu ulur edhe personat që do dëshironin të ishin prezent. Pas kësaj caktohet data e zhvillimit të gjyqit. Në ditën e caktuar, në vendin ku do zhvillohet gjyqi, përveç njerzëve kureshtarë, veç e veç uleshin edhe palët që ishin në konflikt. **Pleqtë**, nga dy anë të kundërta, qëndronin përballë njëri tjetrit në një largësi rreth 100ml, hypur në kuajt e tyre dhe në momentin e duhur fillonin lëvizjen në drejtim të njëri tjetrit.




Fig. - 1 Vendosja e pleqve në 100 ml larg e përballë njëri tjetrit

Ecja e kuajve duhet të jetë e zakonshme. "Debati" mes pleqve fillonte kur kuajt të jenë përballë njëri-tjetrit dhe shumë afër, d.m.th "kokë më kokë", (shih fig. nr 1) ndërsa përgjigja e plakut tjetër duhej të jepej para se kuajt të ishin "bisht për bisht" (shih fig nr 3). Pleqtë kanuntarë thonë se **kanuni në kalë fillon "kokë m'kokë dhe mbaron bisht m'bisht"**.




Fig. - 2 Ky është pozicioni "kokë më kokë" ose fillimi i "gjqit"




Fig. - 3 Ky është pozicioni "bisht më bisht" ose mbarimi i "gjqit"

Siç mund të kuptohet, koha që pleqtë kanë në dispozicion është mjaftë e kufizuar 5-10 sekonda. Ja pikërisht për këtë arsye, kjo praktikë kanunore ishte atribut vetëm i pleqve të regjur si Noka e Lusha në Çidhën.

Lënda kanunore: Një djalosh nga fshati G. N. kishte marrë për nuse një vajzë nga një fshat fqinj. Disa muaj pas martesës, nusja e re, ikën me një djalosh tjetër nga zona me të cilën kufizohej Çidhna. Djaloshi nga Gryka po vëzhgonte situatën, nëse babai i ish gruas do ta bënte për bijë vajzën e tij apo jo. Për këtë arsye, ai disa kohë po ruante nga larg lëvizjet tek shtëpia e ish mikut. Një pasdite ai dalloi nga larg një burrë e një grua që udhëtonin drejt shtëpisë së ish mikut. Ai njohu ish gruan e tij, së cilës i printe një tjetër burrë. Shpejtë e shpejtë zgjodhi pozicionin dhe priti derisa u afruan të dy, burri dhe gruaja. Ngadalë e me qetësi tërhoqi këmbëzën e armës. Gruaja ra e vdekur në tokë. Shpejt u kuptua që këtë vrasje e kishte bërë gryknokasi. Babai i vajzës e mendoi gjatë këtë punë dhe vendosi të nxisë burrin e ri të vajzës të kërkonte gjak tek vrasësi. Pas pak ditësh një plak i dërguar nga familja e dëmtuar trokiti në shtëpinë e gryknokasit duke i thënë: Kam një fjalë prej filanit nga fshati. Më ke gjakun e fëmijës se gruaja ka qënë shtatzënë. Nuk shkoi shumë dhe një tjetër plak drejtohet shtëpisë që iu vra gruaja, e cila ndodhej dy fshatra përtej krahinës së Çidhnës, i cili i thotë: Ke fjalë nga XY (djaloshi grykënokas) unë të kam vra, por të vij në një të drejtë, kur dhe ku të duash ti. Ashtu u bë, secili zgjodhi plakun e vet. Pala e dëmtuar zgjodhi Lushën, ndërsa gryknokasi mori Nokën. Lusha dhe Noka ishin të sprovuar në situata të tilla kanunore. Noka i dërgoi fjalë Lushës që këtë kanun do e ndajmë në Kalë. Lusha menjëherë pranoi pasi, sipas së drejtës, ai duhej të fliste i pari dhe besonte se do ta "gozhdonte" Nokën. U caktua vendi, data dhe ora e zhvillimit të "gryqit". Tek Kroji i Madh në Çidhën do të mbledheshin dhjetra burra që do të ndiqnin "ndeshjen" në mes gladiatorve të së drejtës zakonore. **Stërpleqtë** (ndihmës gjyqtarët) e të dy pleqëve, ndërkohë filluan të merreshin me organizimin.

Në çdo mexhelis nëpër gjithë krahinën filluan debatet, njerëzit hamendsonin se cili do të fitonte. Dikush thoshte Noka e kush Lusha. Interesi u rrit më shumë kur u muar vesh se ky kanun do të "ndahej" në kalë. Dita e "gryqit" erdhi shpejt. Në sheshin tek Kroji i Madh ishin ulur mbi 100 burra të cilët kishin ardhë nga të gjithë fshatrat e Çidhnës, por edhe nga fshati fqinj i krahinës nga vinte personi që i ishte vrarë gruaja. Stërpleqtë u kujdesen që palët në konflikt të vendoseshin larg njëra tjetrës dhe të prisnin përfundimin e "gryqit". Nga ana Shëmërtajthit në kodër dukej kali mbi të cilin qëndronte rëndë rëndë plaku i fisit Noka, ndërsa në anën tjetër ndodhej plaku i Lushës në kalë. Që të dy përballë njëri tjetrit pas një shenje filluan të ecnin ngadalë - ngadalë dhe në kokë secili *bluante* zgjidhjen. Plaku i Lushës sipas së drejtës ishte në avantazh pasi i pari do të shtronte problemin. Ai prej kohësh e kishte përgatitur fjalinë "gozhduese" ndaj dhe priste momentin kur kuajt do ishin "kokë më kokë" përballë njëri tjetrit. Plaku i Nokës ishte mjaft i shqetësuar pasi duhej t'i përgjigjej kundërshtarit në një kohë mjaft të shkurtër. Mijëra variante i kishte çuar në mendje plaku i Nokës, por cila do të ishte "fjalja" e Lushës. Në raste të tilla, në "kanunin në kalë" koha e shkurtër të mundëson vetëm një fjali, nuk ka debate. Me një fjalë a fjali fiton ose humbet "gryqin".

Ndërkohë kuajt po afroreshin dhe plaku i Lushës me solemnitet i drejtohet Nokës: "Pse ma derdhe drithin"? Plaku i Nokës sapo iu përmend fjala "drith" menjëherë dhe falë përvojës së madhe në punët e Kanunit i erdhi përgjigja e shumënjohur: "Mos e futje në thes tim". Të dy kuajt ecën edhe për pak metra në drejtime të kundërta pastaj të dy pleqtë ndaluan, kthyen kuajt dhe bashkërisht u nisën drejt gjithë atyre burrave të cilët prisnin me ankth se cili do të ishte përfundimi. Fjalitë e pleqve edhe pse ishin thënë me zë të lartë, jo të gjithë i kishin dëgjuar mirë ndaj dhe ata u ulën përballë pjesëmarrësve dhe filluan të japin "vendimin".

Fjalën, i pari e mori Lusha i cili iu drejtua djaloshit që i ishte vrarë gruaja: "Dëgjo oj shpia e X, ne e humbëm kanunin. Unë kërkova drithin (fëmijën e vrarë), por e kishim pasë shti në thes të huaj. "Pas Lushës e mori Noka, i cili iu drejtua djaloshit dhe gjithë pjesëmarrësve: Ti or XY, nuk i ke gjak askuj. Çdo grua ku hyn me duvak, del me qefin. Dhe kush nuk është dakord me këtë zgjidhje le të grejë pleqë të tjerë se unë këtu jam."

Gjyqi mbaroi dhe palët nuk mbetën në gjak. Në fund të fundit ky është edhe misioni i çdo pleqërimi: të mos keqësojë situatën dhe të synojë të zbusë zemrat e ndezura të palëve në konflikt. Pleqërimi i bërë në Çidhën nga Noka e Lusha shpejt u bë objekt i bisedave në Dibër dhe më gjërë. Pleqërimi "në kalë" u shndërrua shpejt në "motër-kazus-precedent" edhe për raste të tjera të ngjashme deri në krahinat përreth si Mati, Elbasani, etj.

II. Kanun me shekë të kosit

Këtu bëhet fjalë për një konflikt të ashpër mes fisesh për zgjidhjen e të cilit pleqtë e kanunit bënë një eksperiment fizik në prezencë të palëve të konfliktuara.

Lënda kanunore: Rreth viteve 1870, në fshatin X të Çidhnës dy gra, njëra nusja e tjetra vjehërra, po mbushnin ujë me bucela tek një krua që ndodhej larg nga shtëpitë e fshatit, dmth në një pyll afër. Gjatë kohës që gratë ishin te kroi dhe po mbushnin ujë, një krismë arme dëgjohej dhe të dyja gratë tremben. Ishte krisma e armës së një fshatari, i cili gjuante aty afër. Gratë mbushën bucelat dhe drejtohen nga shtëpia. Porsa shkoi në shtëpi, nusja filloi të ndihej keq dhe shtrihet në krevat. Të nesërmen nusja dështon barrën. Pas kësaj ngjarjeje situata u bë serioze. I shoqi i gruas së dëmtuar e akuzoi gjahtarin se krisma e pushkës së tij ishte shkaku i vdekjes së fëmijës në bark ndaj dhe i kërkon gjakun. Lajmi mori dhenë dhe njerëzit, të afërmit e dy shtëpive në konflikt, filluan të lëviznin për t'i pajtuar. Pasi nuk qe i mundur pajtimi, palët shkuan në të drejtë.

Familja e gjahtarit i deklaroi familjes së dëmtuar se unë të vij në të drejtë dhe pranoj atë plak që do zgjedhesh ti. Kjo ishte një shenjë e fortë dhe tregonte se gjahtari ishte i bindur në pafajsinë e tij. Familja e dëmtuar mori plak Nokën, por edhe familja e gjahtarit atë mori. Plaku i kanunit, Noka, e pranoi sfidën edhe pse i njihte shumë mirë të dy palët në konflikt. Situata kanunore nuk ishte aq e lehtë pasi duke i njohur ato fise, përplasja me armë ishte shumë pranë. Stërplaku i konakut të Nokës, i propozoi Plakut të merrej mendimi i esnafit të bagëtive KM nga Fushë Alia. Meqënëse problemi, (konflikti) kishte marrë vëmendje të madhe në opinion, Plaku i kanunit Noka vendosi që ky gjyq të ndahej larg fshatit dhe pikërisht te Gurra e Gjyqit në Prat. Aty përveç se ndodhej një fushë ku mund të uleshin njerëzit, kishte edhe ujë për të pirë por mbi të gjitha ishte emri Gurra e Gjyqit, i cili për shkak të ndodhive të mëparshme, kishte ndikim në psikologjinë e opinionit. Ishte caktuar data dhe ora e zhvillimit të gjyqit. Koha e tij ishte vendos në mëngjes rreth orës 10. Stërplaku, i porositur nga Plaku kishte siguruar një shekë me kos të xanun një natë më parë, si dhe një armë të njëllajtë me armën e përdorur nga gjahtari. Dita erdhi dhe shumë njerëz varg e varg shkonin drejt Gurrës Gjyq. Afër kroit ulet Noka dhe në krahë të tij dhe stërplaku me shekën e kosit. U zgjodh, nga pjesëmarrësit dëgjues të rastit, edhe çekiçi për të formuar numrin tre të gjyqtarëve apo për të bërë kourumin e "trupës" gjykuese. Plaku i drejtohet me solemnitet gjahtarit: largoju nga këtu, aq sa ke qënë larg kroit atë ditë që ke qëlluar me armë. Gjahtari ngrihet më këmbë dhe duke e mat vendin me sy, zë vend diku përtej. Plaku i kanunit merr miratimin e palës së gruas së dëmtuar për largësinë, ku u vendos gjahtari dhe i jep stërplakut armën e njëllajtë me të gjahtarit, duke i thënë të qëndrojë pranë gjahtarit. Stërplaku bëhet gati të qëllojë në ajër, ndërsa Noka ngrihet më këmbë e ngadalë i afrohet shekës së kosit.

Pas shenjës me dorë të Plakut, krisi pushka. Plumbi çau ajrin duke lënë kumbimin në veshtë e pjesëmarrësve. Stërplaku rëndë-rëndë afrohet te grumbulli i fshatarve dhe i dorëzon armën Plakut të Kanunit, i cili thërret burrin e gruas së dëmtuar, stërplakun dhe çekiçin të cilët afrohen pranë shekës së kosit. Ngadalë, Plaku ia hoqi kapakun asaj dhe i ftoi ato të shohin nëse është "çarë cipa, mbulesa" e kosit apo jo. Burri i gruas së dëmtuar, e vërejti mirë e mirë cipën e kosit në shekë dhe tha: Jo nuk është çarë, nuk ka krisë. U ftuan edhe disa të tjerë për ta parë. Përfundimi ishte i njëjtë: Cipa e kosit në shekë nuk është çarë. Pas kësaj Plaku i kanunit, Noka iu drejtua burrit të dëmtuar: Fëmija n' bark të nanës

është si kosi në shekë. Gjahtari nuk është fajtor për vdekjen e fëmijës. Përmas k'tij shteku çdo gjahtar do i qëndrojë larg kroit sa rref pushka. Kush s'asht dakord të grejë pleqë tjerë e të hahen me mu - Kanuni u nda. Gjahtari mori frymë i lehtësuar. Shumica e njerzëve bashkë me Nokën, por edhe burri i gruas së dëmtuar, u nisën për te shpia e gjahtarit ku do hahej buka, e cila do ishte edhe buka e pajtimit. Nga ajo kohë e deri në ditët tona, kjo praktikë kanunore është thirrë kanuni i "Shekës së kosit".

III. Kanun me k'mesë

Në Dibër janë të njohura dy variante të kësaj ndarjeje kanunore. Them dy variante duke marrë parasyshë mënyrën e "egzekutimit" të vendimit të Plakut. Në Çidhën, Plaku i thirrur për të ndarë Kanunin, ka përdorë këmesën (objekt prerës si satër) për të "ndarë" përgjysmë një fëmijë që e pretendonin dy gra. Kjo ndarje kanuni, e çuditshme, pasi ishte bërë objekt diskutimesh nëpër odat e Maleve të Dibrës, aty këtu, pësoi ndryshime. P.sh në Krahinën e Luznisë, për t'i dhënë ngarkesa emocionale më të forta palëve në konflikt, në vend të prerjes së fëmijës me këmesë, tregohet për "shqyerjen e fëmijës me thonj nga dy gratë".⁽¹⁸⁾

Lënda kanunore: Ngjarja ka ndodhë para viteve 1850, në fshatin X të Dibrës së Poshtëme. Një banor i këtij fshati kishte shumë vite martesë, por nuk kishte fëmijë. Gruaja ishte "vizituar" në sa e sa plaka për tu kthye mbarë, por kishte qënë e pamundur. Burri i bindur se gruaja nuk po lindte, vendosi të marrë një grua tjetër për të mos e mbyllë derën, edhe pse gruaja nuk ishte fare dakord. Ajo, i përsëriste atij prit dhe pak se dhe unë do të lind. Por kur? Pas shumë përpjekjeve nga rrethi miqësor, u arrit të gjendej një grua, edhe pse ajo ishte, "copë mishi me dy sy" dhe gra të tilla quheshin "grua halli". Gruaja e parë filloi të shqetësohet dhe të grindet, por që në ditët e para e kuptoi se nuk do ta kishte të vështirë, pasi e reja ishte shumë e urtë. Kështu, autoriteti i së vjetrës në shtëpi ishte i padiskutueshëm edhe mbi gruan e re, e cila ishte e detyruar ta pyeste të vjetrën apo t'i tregonte asaj për gjithcka. Pas njëfarë kohe, e reja filloi të ndjente shqetësimet e shtatzanisë dhe këtë ia tregoi së vjetrës. Shpejt e vjetra filloi realizimin e planit të cilin kishte kohë që e kishte përgatit. Ajo ia mbushi mendjen gruas së re se "është turp me i tregue burrit për këtë punë" dhe e reja mbylli gojën para burrit. E vjetra mori situatën në dorë dhe një natë i deklaroi të shoqit se kishte mbetë "shtatzënë". Burri u çudit, megjithatë e besoi dhe u gëzua shumë. E vjetra e këshilloi të shoqin që këtë muhabet të mos ia tregonte as gruas së re pasi ajo është e trashë dhe budalle.

Veç kësaj, e vjetra e këshilloi burrin që të marrë udhën e kurbetit pasi pas lindjes së fëmijës familja bëhet e madhe dhe duhet shpi e re, duhet me ble tokë, bagëti, etj. Burri nuk kishte si ta kundërshtonte këtë ide, përkundrazi iu shtua më shumë admirimi për gruan e tij të vjetër, e cila pas shtatzanisë kishte ndryshuar shumë. Ai, ishte shprehur se po të kishte mbetur gruaja shtatzënë para një viti nuk do e kishte marrë edhe këtë tjetrën, të renë. Nuk shkoi shumë dhe burri u nis për kurbet, i cili aso kohe ishte i gjatë në kohë dhe askush nuk kthehej pa bërë 5-6 vite.

Gruaja e vjetër filloi të dalë nëpër lagje, takonte shoqet dhe deklaronte se burri iku në kurbet se duhet me ba shpi të re, pasi kam mbetë shtatzanë dhe na duhet me ble tokë, bagëti, etj. Gruaja e re, që në fakt ishte shtatzënë, qëndronte gjithnjë në shtëpi dhe ndërsa barku i saj rritej ajo i fshihej syrit të grave. E vjetra filloi të ngjishte leckë në pjesën e barkut, duke dhënë pamjen e një barku që çdo ditë fryhej. Pas pak kohësh gruaja e re lindi në shtëpi, siç lindnin asokohe gratë, por në shtrat u shtri e vjetra me djalin e porsalindur në gji, ndërsa e reja shërbente. Filluan të vinin gratë e fshatit dhe uronin. Gruaja e re, i quante për mirë këto veprime të së vjetrës, i dukej normale që djalin e saj po e rriste e vjetra. Kështu jeta vazhdoi në këtë familje dhe djali rritej çdo ditë. E vjetra gjatë gjithë kohës e ushqente djalin me urrejtje ndaj së ëmës biologjike. Situata në familje gjithnjë po vështirësohej për gruan e re. Pas gjashtë vitesh, burri u kthye nga kurbeti dhe gëzimi që i madh, kur pa djalin e tij që luante në oborr. Gruaja e

vjetër po i fliste të shoqit, papushim, për vështirësitë gjatë shtatzanisë dhe sakrificat që kishte bërë për rritjen e djalit. Burri vërejti se gruaja e dytë, e reja, ishte mjaft e dobësuar, ndaj dhe një natë ai ia kërkoi me këmbëngulje arsyen. Gruaja e re merr guximin dhe i tregoi gjithshka. Burri u habit nga ajo që dëgjoji dhe kuptoi çfarë kishte ndodhur. Gruaja e vjetër kishte bërë hak të largohej menjëherë nga shtëpia.

Në lojë hynë edhe vëllezërit e gruas së vjetër dhe njerzit e së resë. Situata u ngatërrua shumë. Shumë veta në fshat, edhe pse të çuditur, thonin se djalin e lindi e vjetra, ndërsa kishte të tjerë që thonin të kundërtën duke e quajtur të vjetrën grua të keqe. Një ditë ai e pyeti të vjetrën se kush e ka lindur djalin. Gruaja u bë si e gjindosur dhe filloi të bërtasë: Ti mos dëgjo atë budallen se ajo nuk di çfarë thot, po pyet gratë e katundit se ato e dinë. Burri i zënë ngushtë, kërkoi ndihmë për zgjidhjen e kësajë situate. Dikush e këshilloi të kërkonte ndihmë te Lusha në Arras, si njëri ndër pleqtë e njohur në Dibër për zgjidhjet kanunore që kishte dhënë. Një ditë prej ditësh, ai trokiti në derë të Lushës dhe ia tregoi gjithë historinë. Lusha e merr përsipër dhe i caktoi ditën dhe kushtet për zhvillimin e "gjqit". Në atë ditë do të ishin prezent njerëzit e afërt të të dyja grave. Dita erdhi. Në shtëpinë e fshatarit atë ditë përveç miqve (të afërmit e dy grave) ishin edhe disa miq të zotit të shtëpisë. Pas pak u dukën edhe tre veta hypur në kuaj. Ishte Plaku i kanunit bashkë me dy stërpleqë të konakut të tij. Hynë brenda dhe pas kafesë Plaku kërkoi të "marrë" në pyetje dy gratë. Në fillim ai thirri të vjetrën, e cila u ul përballë "trupës" gjyquese, në mes të dhomës ndërsa djali i vogël qëndronte afër të atit pa kuptuar asgjë se ç'po ndodhte. Kush e ka lindë atë fëmijë, pyeti Plaku. Gruaja e vjetër turfulloi dhe tha unë e kam lindë, e kam mbajtur nëntë muaj në bark, e dinë gjithë katundi. Plaku urdhëroi gruan të shmanget pak e të qëndrojë aty përballë trupës gjyqësore.

Pas kësaj u thirr gruaja e dytë, e reja. Edhe ajo zuri vend para "gjqtarve". Sërish Plaku pyeti - Kush e ka lindë atë fëmijë? Gruaja e re e ndrojtur me gjysmë zëri tha: unë, dhe nga sytë i rridhnin lotë. Plaku i drejtohet babit të djalit dhe i thotë: Më sill një këmesë dhe një grihën të mirë. Kur këmesa dhe grihni erdhën, plaku ia dha stërplakut duke i thënë: M'pafe mirë këtë këmesë se do e presim këtë fëmijë përgjysë, tua ndajmë dy grave. Stërplaku filloi të mprehte këmesën dhe herëpashere e provonte me dorë. Të gjithë pjesëmarrësit kishin shtangë nga ato fjalë që tha plaku. Pas pak plaku mori këmesën dhe pasi u sigurua se ishte mpreh mjaftueshëm iu drejtua një të riu aty me të cilin plaku kishte biseduar më parë për rolin që ai do të luante: hajde ti se je më i fortë dhe kur të të them unë, këta të dy stërpleqtë do e kapin djalin e vogël njëri për njëres këmbë e tjetri për tjetres dhe ti do i biesh ta presish djalin e vogël, por ta presësh drejt që çdo njëra prej këtyre grave të marrë pjesën e vetë në mënyrë të barabartë. Fjalët patën efekt, pasi filluan pëshpëritjet nga gjithë pjesëmarrësit. Gruaja e vjetër qëndronte e qetë, ndërsa e reja ishte mjaft e shqetësuar. Dy stërpleqtë ngrihen kapin djalin për krahësh dhe vihen në mes të dhomës, ndërsa i riu me këmesë në dorë qëndronte para trupës gjyqësore gati për të vepruar. Plaku tha: para se ta presim këtë djalë do ti pyes edhe njëherë gratë. Iu drejtua gruas së vjetër: A ta pres djalin që të merrni secila gjysmën? I menjëhershëm ishte përgjigja e saj - Po, veç preje. Plaku iu drejtua gruas tjetër: A ta presim djalin që të merrni secila gjysmën? Gruaja e re e trembur shumë se vërtetë ato do e prisnin fëmijën tha: Jooo mos e prisni, le ta mbajë ajo (e vjetra), veç djali të jetojë. Atëhere Plaku u ngrit në këmbë dhe kapi djalin me dorë dhe tha: Këtë fëmijë e ka lindë kjo grua. Merre fëmijën dhe e gëzofsh. Pastaj i drejtohet gruas së vjetër: Ti nuk je nënë, por as njeri nuk je! Paç faqen e zezë! Njerzit e gruas së vjetër nuk pritën ma, por mblodhën cigaret dhe dolën duke marrë me vete edhe motrën e tyre, e cila nuk kishte më vend në atë shtëpi.

IV. Pajtim, ja me dalë fare

E dalmja fare ishte njëra nga mënyrat shtërnguese që ka funksionuar në Dibër të Poshtëme për të detyruar palët e konfliktuara të shkojnë drejt pajtimit. Kjo masë apo formë shtërnguese në Malet e Dibrës, është e njohur edhe pse janë të rralla rastet kur ajo është praktikuar pasi edhe kushtet në të cilat

ajo duhej të zabtohej ishin specifike dhe të rënda. Sipas së drejtës zakonore, për zbatimin e kësajë praktike shtërnguese, palët e konfliktuara duhej të viheshin në të njëjtën dhomë dhe nuk dërgohej njeri për t'ju shërbyer, as për kafe e as për t'iu dhënë zjarr. Veç kësaj, tek dera ku hynin palët në gjak, viheshin dy djem të armatosur dhe porositeshin që në rast se dëgjoheshin krisma nga brenda dhomës, ata qëllonin mbi këdo që del jashtë.

Ndoshta prej shumë shekujsh, kjo s'kishte ndodhë edhe pse njihej si "praktikë" për pajtim, por rrethanat dhe dështimi i të gjitha formave tjera, i kishte detyruar krerët që ta zbatojnë. Ne po sjellim një rast, ku kjo formë shtërngese u përdorë pasi nuk dhanë rezultat përpjekjet, thirrjet, ndrëmjetësimet për të pajtuar dy fise në një konflikt të gjatë, i cili sa më shumë zgjatej sillte vrasje të reja. Dy fise të mëdha në Çidhën, Sulet me Koltraket prej vitësh ishin në gjak dhe konflikti kishte marrë nëntëmbëdhjetë jetë njerëzish. Që të dy këto fise kishin jetuar gjatë me të *m'shela*. Herë nga njëra palë e herë tjetra, vritej dikush dhe kështu vazhdonte prej gati 20 vitësh. Hera-herës, ishin krijuar mundësi për të ndërhyrë në pajtim, por, ose nuk pranonte njëra palë, ose personat që merreshin me këtë problem nuk ishin gjithnjë ato të duhurit. Nuk kishte mbetur plak a stërplak, që nuk ishte marrë me këtë punë. Lutjet e thirrjet për pajtim ishin të panumërta, por asgjë nuk ishte arritur. Përmasat e konfliktit nuk po zvogëloheshin asnjëherë dhe kjo ishte shqetësuese për gjithë krahinën. U mendua se për dy fiset, Sulet e Koltraket, nuk kishte mbetur rrugë tjetër, veçse me i vu para alternativës: "*O pajtohuni, o dilni fare*". Ishte një mendim e më pas vendim i bluar e i peshuar shumë gjatë. Dhe rasti erdhi. Salë Demir Alia kishte dasëm dhe meqënëse i kishte miq të dy palët e konfliktuara, vendosi tu vërë kusht pajtimin. Salë Demir Alia e njihte situatën e gjaqeve mirë dhe e dinte se fisi i Sule kishte për të marrë një gjak te Koltraket. Nuk kishte kaluar shumë kohë, kur ishte plagosë djali i njërit prej burrave më të njohur në Çidhën, djali i Selman Sulit (Çuni). Salë Demiri shumë herë e kishte prekë hollë këtë problem në bisedë me Selman Sulin (Çunin), i cili ishte i një mendjeje me shumicën e njerëzve, se konflikti me Koltraket kishte kohë që nuk pëlqej, që kritikohet dhe që duhej frenuar edhe pse atij i ishte plagosë djali dhe gjaku i tij ishte pa u marrë.

Salë Demiri (Alia) vendosi t'i kujtojë babait të të plagosurit, se në Kanun, është edhe një normë, *që të detyron me u pajtue ose me dalë fare*. Dhe kështu bëri. Ai thirri Selman Sulin (Çunin) në shtëpi dhe larg e larg ia zuri bisedën. Selman Suli (Çuni) ishte mjaft i zgjuar dhe menjëherë e "thithi" muhabetin dhe u përgjigj: "*Unë e marr vesh se ç'thua ti, o Aga, edhe atë normën e detyrimit me u pajtue e di, por gjak i madh asht' derdhë dhe nuk është kollaj!*" Salë Demiri (Alia) ia kthen: *Epo, punët e rënda e të vështira, prandaj janë lënë për burrat e qanun*. Biseda mbaroi. Selman Suli (Çuni) shkon në shtëpi të vet e agai në të tijën. Pas pak kohësh, rasti e solli që Salë Demiri (Alia) kishte dasëm, ndaj vendosi që të bëjë hapin e rëndë e të vështirë, për t'i shtërnguar dy fiset e fuqishme të krahinës të pajtohen.

Agai i Çidhnës, i ftoi dy fiset që ishin në konflikt pasi i kishte miq shtëpie. Dita e dasmës erdhi dhe në dhomën e caktuar nga Sali Demiri, në fillim hynë Sulet. Pas dy orësh erdhën edhe Koltraket. Edhe këto u pritën me nderime dhe i drejtuan për tek konaku, ku ndodheshin edhe hasmit e tyre, Sulet. Nuk kishte burrë që nuk drithërohej nga kjo skenë. Koltraket hynë brenda në konak dhe habiten kur gjejnë aty hasmit e tyre! Në krye të vendit ishte Selman Suli (Çuni), i cili ia liron atë të parit Koltrake. U ulën. Në njërin anë të dhomës u vendosën Sulet dhe në anën tjetër Koltraket, përballë njëri tjetrit, të gjithë hijerëndë e të gërthyer me armë. I pari e mori fjalën Selman Suli (Çuni), të cilit, Koltraket i kishin plagosë djalin para një viti. *A je tu e pa se ç'na kanë ba, or Koltrak? Po, iu përgjigj Koltraka, i cili për shkak se kishte borxh me la, nuk fliste asnjëherë para Sulit. Përsëri foli Selman Suli (Çuni): Ene hyzmetçi nuk na kanë pru këtu e kjo do të thotë që na, ja duhet me u pajtue, ja duhet me dalë fare. Të kam të parë, or Selman! - ia ktheu Koltraka, - unë rri ku të më vesh ti!*

Biseda ishte e rëndë, por burrat si Selman Suli (Çuni), rrallë i vijnë krahinës. Unë mendoj që të caktojme një që të na japë zjarr e kafe, e pastaj dy prej të mijëve e dy prej tuve të barazojnë gjaçet, - përfundoi Selman Suli (Çuni). Ashtu u bë, dolën katër veta dhe u ulën në fund të dhomës së madhe të Alie e filluan të numërojnë gjaçet, ndërkohë që Selman Suli (Çuni) atë ditë do të kryente një akt të lartë burrëror. Ai e njihte mirë djaloshin e Koltrake që i kishte plagosur djalin, i cili ishte ulur në fund të dhomës dhe sytë nuk i ngrinte fare. Pinte duhan mendueshëm dhe mallkonte veten për veprimin që kishte bërë një vit më parë. Përsëri foli Selman Suli (Çuni): *Unë them që ai djali në fund të dhomës të na bëjë hysmet*, - dhe gishtin e drejtoi pikërisht tek ai që i kishte plagosur djalin dhe vazhdoi: - *Ngreu e na jep një zjarr!* Koltraka i ri brofi në këmbë, kapi mashën që ishte pranë votrës, mori një poptesh dushku nga zjarri dhe iu afrua Selman Suli (Çunit), i cili kishte vënë llullën në gojë dhe priste zjarrin. Djali iu afrua me mashën në njërën dorë e dorën tjetër në zemër. Askush nuk fliste, tensioni ishte shumë i lartë. Të gjithë i kishin armët në brez dhe askush nuk e dinte se ç'bluante në mendje Selman Suli (Çuni). Po sikur Koltraka i vuri zjarrin në llullë dhe, kur po largohej, plaku i Sule ngriti sytë dhe iu drejtua djalit: *Ti je ai që ke plagosur djalin tim? Po, ia ktheu Koltraka*, - dhe drejtoi trupin e qëndroi ashtu më këmbë në mes të dhomës. *Unë ta kam falë gjakun e djalit tim, prandaj afroju e më jep dorën!* Djaloshi i Koltrakes shtangu dhe masha që pati në dorë i ra në mutaf. Ai iu afrua Selman Sulit (Çunit), e përqafoi dhe sytë i kishte plot me lot. Ai mallkonte me shpirt atë ditë që ngriti dorën e shtiu mbi djalin e këtij plaku të urtë.

PËRFUNDIME

Ky veprim e shtensionoi situatën dhe ndërkohë grupi i gjaçeve nga fundi i dhomës njoftoi se tani jemi baras. Të gjithë e dinin se duhej të falej plagosja e djalit të Selman Sulit (Çunit) që të barazoheshin gjaçet. Pas këtij momenti në dhomë vërshuan shumë njerëz, miq ë të ftuar të cilët përgëzonin Selman Sulin dhe gjithë të tjerët për pajtimin e këtij konflikti kaq të stërgjatur mes dy fiseve të zëshëm në Dibër.

STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA

1. Sinani Sh. "Tradita si etnotekst" fq 50
2. Sinani Sh. "Etnosi në epos" fq 202
3. "E drejta zakonore shqiptare" fq 8
4. Sinani Sh. "Etnosi në epos" fq 227
5. Sinani SH. "Etnosi në epos" fq 227
6. Palaj B. "Bota e maleve shqiptare" fq 147
7. Bardhoshi N. " Antropologji e kanunit" fq 30
8. Sinani Sh. "Antropologji etnojuridike" pj. II, fq 55
9. Pulaha S. "Konferenca Komb. e stud etnogr." fq 160
10. Frashëri K. "Konf. Komb. e stud etnogr" fq 241
11. Frashëri K. Vepër e cituar fq 240
12. Bardhoshi N. "Antropologjia e kanunit" fq 28
13. Bardhoshi N. "Antropologjia e kanunit" fq 127
14. Cituar nga "Antropologjia e kanunit" fq 131 e Bardhoshi N.
15. Bardhoshi N. "Antropologjia e kanunit" fq 123
16. Faverial Zh.K. "Historia më e vjetër" fq 333
17. Nga FGJSH, shek/e-ja, enë druri
18. Intervistë e vitit 2020, me Haki Manukën